



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 23 gusht 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Riklasifikimin e Materialit Provues

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 23(1) dhe 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 80(1) dhe 84(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 11 prill 2022, Mbrojtja e Kadri Veselit (“Mbrojtja e Veselit”) paraqiti kërkesë për riklasifikimin e materialit provues (“Kërkesa e Veselit”).²
2. Më 20 dhe 22 prill 2022, përkatësisht Mbrojtja e Hashim Thaçit (“Mbrojtja e Thaçit”) dhe Mbrojtja e Jakup Krasniqit (“Mbrojtja e Krasniqit”), iu bashkuan Kërkesës së Veselit (përkatësisht “Mocioni i Thaçit për Bashkim me Kërkesën” dhe “Mocioni i Krasniqit për Bashkim me Kërkesën”).³
3. Më 22 prill 2022, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) iu përgjigj Kërkesës së Veselit (“Përgjigjja e ZPS-së”).⁴
4. Përkatësisht, më 29 prill 2022 dhe 2 maj 2022, Mbrojtja e Veselit dhe Mbrojtja e Thaçit iu kundërpërgjigjën përgjigjes së ZPS-së (përkatësisht “Kundërpërgjigjja e Veselit” dhe “Kundërpërgjigjja e Thaçit”, dhe së bashku, “Kundërpërgjigjet e Mbrojtjes”).⁵ Mbrojtja e Krasniqit nuk dorëzoi kundërpërgjigje.

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00766, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Riklasifikimin e Materialit Provues*, 11 prill 2022, publike.

³ KSC-BC-2020-06, F00773, Mbrojtësi i Specializuar, *Mocion i Mbrojtjes së Thaçit për Bashkim me Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Riklasifikimin e Materialit Provues*, 20 prill 2022, publike; F00776, Mbrojtësi i Specializuar, *Mocion i Mbrojtjes së Krasniqit për Bashkim me Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Riklasifikimin e Materialit Provues*, 22 Prill 2022, publik.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00778, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë Ndaj Kërkesës së Veselit për Riklasifikim*, 22 prill 2022, publike.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00785, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Veselit për Riklasifikim*, 29 prill 2022, publike; F00793, *Kundërpërgjigje e*

II. PARASHTRIMET

5. Mbrojtja e Veselit, Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja Krasniqit (bashkërisht, "Mbrojtja") parashtojnë se ZPS-ja, pa dhënë arsye, i ka klasifikuar si konfidenciale të gjitha materialet provuese të nxjerra deri më tani për Mbrojtjen, duke shkelur kështu rregullën 83(1) të Rregullores dhe, në përgjithësi, të drejtën e të akuzuarve për një proces të drejtë dhe publik siç mishërohet, ndër të tjera, në nenin 21(2) të Ligjit.⁶ Mbrojtja kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake: (i) të urdhërojë ZPS-në të riklasifikojë çdo material jokonfidencial si publik; (ii) të urdhërojë ZPS-në të justifikojë klasifikimin konfidencial të materialeve provuese që nuk janë të disponueshme publikisht; dhe (iii) të caktojë një afat për përfundimin e riklasifikimit të materialit të nxjerrë nga ZPS-ja.⁷

6. ZPS-ja u përgjigj se Mbrojtja e keqinterpretonte kuadrin e parimit të procesit publike dhe se në veçanti në fazën e tanishme të procedurës paraprake, klasifikimi konfidencial mbetet i përshtatshëm për një pjesë të konsiderueshme të materialeve provuese, duke përfshirë materialet që mund të duken se janë publike.⁸ Megjithatë, ZPS-ja "informon se do t'i shqyrtojë, dhe aty ku është e përshtatshme, do ta ndryshojë klasifikimin e materialeve provuese përpara fillimit të gjykimit dhe [...] [se] klasifikime të tilla do të shqyrtohen gjatë gjithë procesit".⁹

7. Kundërpërgjigjet e Mbrojtjes kryesisht përsërisin parashtrimet e bëra në Kërkesën e Veselit, Mocionin e Thaçit për Bashkim me Kërkesën dhe Mocionin e Krasniqit për Bashkim me Kërkesën.

Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Veselit për Riklasifikim, 2 maj 2022, publike.

⁶ Kërkesa e Veselit, para. 2, 8, 10; Mocioni i Thaçit për Bashkim me Kërkesën, para. 2-3; Mocioni i Krasniqit për Bashkim me Kërkesën, para. 2-3.

⁷ Kërkesa e Veselit, para. 1, 14-16; Mocioni i Thaçit për Bashkim me Kërkesën, para. 1, 5; Mocioni i Krasniqit për Bashkim me Kërkesën, para. 1, 6.

⁸ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2-3.

⁹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 7.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Në pajtim me nenin 21(2) të Ligjit, i akuzuari ka të drejtën e një procesi të drejtë dhe publik.
9. Në pajtim me nenin 23(1) të Ligjit dhe rregullën 80(1) të Rregullores, Dhomat e Specializuara do të sigurojnë mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve duke përfshirë sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre.
10. Në pajtim me nenin 39(1) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencë që të lëshojë çdo urdhër apo vendim të nevojshëm për të siguruar që çështja të përgatitet siç duhet dhe në mënyrë të shpejtë për gjykim.
11. Në pajtim me rregullën 83(1) të Rregullores, çdo dokument i procesit gjyqësor dhe i provave që nuk është publik evidenton arsyen e një klasifikimi të tillë si dhe nëse mund të ndryshohet statusi i klasifikimit të dokumentit në fjalë.
12. Sipas rregullës 84(1) të Rregullores, Trupi Gjykues rishikon vazhdimisht klasifikimin e dokumentacionit të procesit gjyqësor dhe provave dhe kur është e zbatueshme, urdhëron riklasifikimin e tij.

IV. DISKUTIM

13. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në pajtim me rregullën 83(1) të Rregullores, çdo dokument i procesit gjyqësor dhe i provave që nuk është publik evidenton arsyen e një klasifikimi të tillë si dhe nëse mund të ndryshohet statusi i klasifikimit të dokumentit në fjalë. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe

Çështje lidhur me To (“Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave”),¹⁰ i cili specifikon se “[...] kur nxjerrin prova, palët përcaktojnë nivelin e përshtatshëm të klasifikimit për secilën provë dhe i regjistrojnë provat si publike, përveçse kur ka arsye që t’i klasifikojnë ndryshe, në pajtim me rregullën 83(1) të Rregullores”.¹¹

14. Për një pjesë të konsiderueshme të materialit provues të nxjerrë, veçanërisht materialet e lidhura me dëshmitarët (deklaratat e marra nga ZPS-ja dhe institucionet e tjera, si dhe materialet që lidhen me ato deklarata) ose materialet e marra nga institucione të tjera ndërkombëtare,¹² Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka urdhëruar masa mbrojtëse pas shqyrtimit të arsyetimeve përkatëse të paraqitura nga ZPS-ja. Për këtë arsye, ky material mban klasifikimin e vet deri në momentin kur shfuqizohen masat mbrojtëse të urdhëruara, ose nëse paneli urdhëron ndryshe. Kërkesa e Veselit nuk ka të bëjë saktësisht me këtë material.

15. Për sa i përket materialit që është i disponueshëm publikisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, pavarësisht nga disponueshmëria e tij publike, mund të ekzistojnë arsye për klasifikimin konfidencial të një materiali të tillë në procesin në Dhomat e Specializuara. Për shembull, materiali i disponueshëm publikisht mund të duhet të mbahet konfidencial, në këtë fazë: (i) për të mbrojtur sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dhëna nga dëshmitarë të Dhomave të Specializuara;¹³ ose (ii) sepse disa detaje të përfshira në të ose përfundimet që nxjerr ZPS-ja prej tyre nuk janë (ende) publike.¹⁴ Për më tepër,

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To*, 23 nëntor 2020, publik.

¹¹ Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave, para. 48, që përmendet në poshtëshënimin 66 të ICC, *Prosecutor v. Yekatom*, ICC-01/14-01/18-64-Red, Pre-Trial Chamber II, [Public Redacted Version of “Decision on Disclosure and Related Matters”](#), 23 January 2019, para. 17.

¹² Neni 58 i Ligjit.

¹³ *Shih gjithashtu* Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave, para. 82.

¹⁴ *Shih për shembull*, KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 24 mars 2022, publik, f. 1160, rreshti 14 deri në f. 1161, rreshti 10 (Urdhri Gojor në lidhje me Riklasifikimin e F00744). *Ngjashëm*, KSC-BC-2020-07,

çështja e (ri-)klasifikimit të materialeve jokonfidenciale duhet të konsiderohet më tej kundrejt klimës së përgjithshme të ndërhyrjes dhe frikësimit të dëshmitarëve që mbizotëron në Kosovë. Rrjedhimisht, një material i tillë gjithashtu mban klasifikimin e tij, përveç rastit kur paneli urdhëron ndryshe.

16. Mbrojtja pretendon se riklasifikimi është i nevojshëm për të bërë efektive të drejtën e të akuzuarve për proces publik. Ndërkohë që procesi publik është e drejtë themelore e të akuzuarit sipas nenit 21(2) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se kjo e drejtë nuk është absolute, por u nënshtrohet kufizimeve të nevojshme për të mbrojtur interesat e tjera, duke përfshirë sigurinë e dëshmitarëve. Për më tepër, provat nuk diskutohen në fazën paraprake, por në gjykim. Si rezultat, materiali provues mund të mbetet konfidencial në fazën paraprake, siç përshkruhet më sipër.

17. Nga ana tjetër, procedura paraprake është në një fazë të avancuar, është urdhëruar dorëzimi i dosjes paraprake të Mbrojtjes,¹⁵ procedura e shtyrjes së nxjerrjes së informacionit ka përfunduar për disa dëshmitarë dhe identiteti i tyre i është bërë i ditur Mbrojtjes,¹⁶ hetimet e Mbrojtjes kanë nisur prej disa muajsh,¹⁷ ekziston një kornizë për trajtimin e informacionit konfidencial,¹⁸ dhe kalimi i dosjes gjyqësore te një trup gjykues do të ndodhë në të ardhmen e afërt.

18. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPS-ja e pranon pa rezerva parashtrimin e Mbrojtjes se i ka klasifikuar të gjitha materialet provuese të nxjerra deri më tani si konfidenciale. Po ashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake

F00556, Trupi Gjyqësor II, *Vendim në lidhje me Kërkesën për Riklasifikimin e Parashtrimit të Protokolluar F00500*, 8 shkurt 2022, publik, para. 13.

¹⁵ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 20 maj 2022, publik, f. 1324, rreshtat 1-6.

¹⁶ KSC-BC-2020-06, F00647, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Versioneve me më pak redaktime të Aktakuzës dhe Përmbledhjes sipas Rregullës 86(3)(b)*, publike, para. 1, me shtojcat 1-2 të redaktuara konfidenciale.

¹⁷ *Shih* parashtrimet e bëra nga Mbrojtja në shkurt 2022, KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 22 shkurt 2022, publike, f. 985, rreshtat 7-11; f. 1020, rreshtat 15-16.

¹⁸ KSC-BC-2020-06, F00854, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës Kundërshtare ose të një Pjesëmarrësi*, 24 qershor 2022, publik.

është i vetëdijshëm për faktin se nxjerrja e provave në fazën paraprake mund të përfshijë materiale të cilat nuk mund përdoren dhe diskutohen nga asnjëra palë në gjykim. Rrjedhimisht, është më e përshtatshme që klasifikimi i materialit provues jokonfidencial të trajtohet më afër diskutimit në lidhje me të në gjykim.

19. Duke mbajtur parasysh rregullën 83(1) të Rregullores dhe në funksion të përgatitjes së duhur dhe të shpejtë të çështjes për gjykim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron të përshtatshme që ZPS-ja në vijim të shqyrtojë materialin provues jokonfidencial të nxjerrë deri më tani ("materiali jokonfidencial") dhe të identifikojë: (i) materialin që mund të riklasifikohet si publik në këtë fazë; (ii) materialin që duhet të mbetet konfidencial deri në fazën e gjykimit, arsyet për këtë gjë dhe në cilin moment konkret të fazës së gjykimit ky material mund të riklasifikohet si publik; dhe (iii) materialin që duhet të mbetet konfidencial gjatë të gjithë procesit dhe arsyet për këtë gjë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se duhet të shqyrtohet i gjithë materiali jokonfidencial ndërkohë që Mbrojtja kryen hetimet.

20. Informacioni për riklasifikimin e mundshëm të disa materialeve jokonfidenciale në gjykim do të përfshihet në Dokumentin Dorëzues për t'u shqyrtuar më tej nga Trupi Gjykses.

V. VENDIM

21. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **RRËZON** pjesën e Kërkesës ku Gjykatësit të Procedurës Paraprake i kërkohet të urdhërojë tani riklasifikimin e materialit provues jokonfidencial;
- b. **URDHËRON** ZPS-në të shqyrtojë materialin jokonfidencial dhe të dorëzojë, **të premtën, 4 nëntor 2022**, një listë që bën të ditur:
 - i. cili material mund të riklasifikohet si publik në këtë fazë;
 - ii. cili material duhet të mbetet konfidencial deri në fazën e gjykimit, arsyet për këtë gjë dhe në cilin moment konkret të fazës së gjykimit, ky material mund të riklasifikohet si publik;
 - iii. cili material duhet të mbetet konfidencial gjatë të gjithë procesit dhe arsyet për këtë; dhe

- c. **URDHËRON** ZPS-në, që kur t'i nxjerrë Mbrojtjes materiale të tjera jokonfidenciale, të përcaktojë nivelin e duhur të klasifikimit, të tregojë arsyet për çdo klasifikim jopublik dhe të tregojë nëse dhe kur mund të riklasifikohet ky material jokonfidencial, në përputhje me rregullën 83(1) të Rregullores.

_____/nënshkrim/____

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E martë, 23 gusht 2022

Hagë, Holandë.